



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN SHKENCORE  
NDËRKOMBËTARE NË 101-VJETORIN E MIRATIMIT TË RREGULLORES SË  
PARË TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

*5 mars 2021*

E nderuar nënkryetare Hysi,  
I nderuar rektor Hoxha,  
Të nderuar të ftuar specialë,  
Të nderuar pjesëmarrës,

Faleminderit që më jepni privilegjin t'i drejtohem një audience të një niveli kaq të lartë e të shquar. Jam i lumtur që përshëndes hapjen e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare në 101-vjetorin e miratimit të Rregullores së Parë të Kuvendit të Shqipërisë "Roli i parlamenteve në vendimmarrjen publike në të shkuarën dhe të tashmen në Shqipëri". Megjithëse do të kisha dashur që kjo konferencë të zhvillohej me pjesëmarrje fizike, prapë jam i lumtur që sot përdorim teknologjinë për t'u mbledhur e për ta ruajtur këtë mundësi.

Vitet që shërbejnë si gur kilometrik, si 100 apo 101-vjetori, japin mundësinë për të hedhur vështrimin pas, për të festuar arritjet dhe për të dhënë energji të re vizionit tonë. Është e dukshme nga programi i kësaj konference dhe nga të ftuarit që, në zemër të Kuvendit, qëndron puna e drejtuesve politikë, juristëve dhe e botës akademike. Kuvendi ka përqaftuar me sukses parimet dhe vlerat e pjesëmarrjes, hapjes, transparencës, barazisë gjinore, mësimet e mësuara dhe ekspertizën e parlamenteve të tjera. Kjo është vërtet një vlerë e madhe, që meriton të festohet.

Falënderoj veçanërisht bordin e konferencës dhe folësit, që hartuan një program kaq të rëndësishëm për konferencën. Gjithëpërfshirja dhe qasja shumëpërmasore e tij janë parimet që OSBE-ja i ka në thelb të saj kur punon për të arritur zhvillim, paqe dhe siguri.

I jam mirënjohës zëvendëskryetares së Kuvendit, Vasilika Hysi, për bashkëpunimin tonë dhe për prezantimin e shkëlqyer që bëri për Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, në nëntor 2020. Sikurse mund ta dini, nëntorin e shkuar, unë solla në vëmendje të të 57 Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së veprimtaritë tona të rëndësishme me Kuvendin e Shqipërisë.

Në fakt, Prezenca e OSBE-së dhe Kuvendi kanë lidhje të forta. Jeta parlamentare e Shqipërisë është e një përparësie kyçe për Prezencën e OSBE-së. Që në vitin 2003 bashkuam forcat për të mbështetur procesin e hartimit të rregullores së Kuvendit. Rregullorja e miratuar në dhjetor 2004 është ende në fuqi, sigurisht me ndryshimet e nevojshme përgjatë viteve. Duke reflektuar për këtë proces të shtrirë në thujse dy dhjetëvjeçarë, angazhimi i njëmendtë i deputetëve të të gjitha forcave politike krijoi një produkt, i cili u miratua me konsensus të plotë. Një proces që u konsultua me praktikën më të mira parlamentare të kohës, u frymëzua nga modelet italiane, austriake dhe franceze dhe edhe nga pjesë të modeleve të tjera evropiane dhe rajonale dhe që u përshtat për kontekstin shqiptar. Kjo rregullore ende përfaqëson një dokument pune të gjallë dhe thelbësor për funksionimin normal të proceseve parlamentare.

Ndryshimet e bëra në Rregullore në vitin 2019 e pasuruan më tej këtë dokument. Disa nga pikat – integrimi i perspektivës gjinore, i qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, si edhe theksi që iu vu kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare – janë vërtet hapa të rëndësishëm për të pasur një dokument pune të parlamentit, që pasqyron vlerat demokratike në thelbin e tij dhe përfshin nevojat e shoqërisë.

Më 2020, pandemia Covid-19 vështirësoi shumë sfera të jetës e të punës në mbarë globin. Por Kuvendi i Shqipërisë ishte një ndër parlamentet e para në Evropë dhe në rajon që reagoi shpejt dhe iu përshtat nevojave dhe sfidave të reja. Me krenari, ne punuam së bashku me Kuvendin duke i dhënë mbështetje teknike, gjë që mundësoi organizimin e takimeve të komisioneve parlamentare dhe strukturave të tjera përmes mjeteve të komunikimit elektronik. Kjo përshtatje e shpejtë me teknologjinë digjitale u vlerësua si praktikë e mirë edhe nga Komisioni Evropian në Raportin Vjetor 2020, si dhe në Raportin e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Sfidat e 2020-s u shndërruan në mundësi, duke shtuar transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve.

Me afrimin e zgjedhjeve të prillit, ne presim me padurim të vijojmë punën me legjislaturën e re.

Punimet e sotme më japin mundësinë të theksoj rëndësinë e një veprimtarie lidhur me legjislacionin elektronik, që do të materializohet së shpejti. Kjo është një përpjekje e rëndësishme për të rritur efikasitetin, efektshmërinë dhe transparencën e Kuvendit, duke ofruar një qasje të integruar për sistemet legjislative e duke kontribuar në konsolidimin e dokumentacionit parlamentar.

Një partnere kryesore në këto përpjekje shumë të rëndësishme me Kuvendin është Agjencia Zvicerane e Zhvillimit. Më lejoni të shpreh edhe një herë mirënjohjen e veçantë për ambasadorin e Zvicrës në Shqipëri, SH.T. Adrian Maître, dhe për ekipin e tij të shkëlqyer për mbështetjen e vazhdueshme si pjesë e projektit 4-vjeçar “Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar në Shqipëri”, i cili po zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë.

Pa u zgjatur, lejomëni edhe përsërit që ka qenë një privilegj për OSBE-në të punojë me botën akademike, shoqërinë civile, median, institucionet e ndryshme shtetërore dhe me Kuvendin. Ka qenë privilegj të shohim, gjithnjë e më shumë, ndërveprimin dhe veprimet të përbashkëta për të ndërtuar shoqëri dhe institucione demokratike.

Më lejoni, edhe në emër të ambasadorit të Zvicrës në Shqipëri, t’ju uroj një konferencë shumë të suksesshme.

Faleminderit!